

FJALA E DEPUTETIT BUJAR ÇELA E HËNË 23 TETOR 2021

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar përfaqësues të kabinetit qeveritar,

Kjo “Javë e gjelbër”, takimi me qytetarët, është një javë shumë e rëndësishme, shumë e domosdoshme, sepse dëgjojmë ata që na kanë sjellë në këtë sallë. Unë dua që vëmendjen kryesore ta kenë ministrat, sepse janë pikërisht në kohën e duhur për rregullimin, sajimin e projektbuxhetit, në mënyrë që të bëjmë të mundur zbatimin e kërkesave të qytetarëve tanë, majtas apo djathtas. Dëgjova të gjithë ata që folën deri tani. Kishte edhe të majtë, edhe të djathtë, që flasin vetëm nga podiumi, por nuk e njohin realitetin. Më vjen keq. Disa hiqen sikur kanë ardhur dje në parlament. Ka ish-qeveritarë dhe qeveritarë që mundohen ta shesin hallin sikur është hall i ri. Jo, këto janë halle të vjetra. Unë përshëndes ministren e Bujqësisë, që ka qenë në njëqindvjetorin e shkollës së parë bujqësore në Lushnjë, ku është një qendër teknologjie bujqësore, e trashëguar që nga viti 1921. Shohim edhe drejtorin e Institutit Bujqësor të Tiranës, por na mungojnë agronomët. I kemi sot profesorët. A ka mundësi që të hapet ky filial, sepse ka shumë agronomë që nuk regjistrohen më? Bujqësia ka nevojë. Do t’i kërkojmë të prodhojnë agronomë të rinj, por nuk do të kemi profesorët. Mendoj se ky filial është i domosdoshëm dhe me një bashkëpunim qeveri qendrore - qeveri vendore kjo gjë bëhet e mundur. Lushnja ka prodhim shumë të madh eksporti, që ka qenë edhe në socializëm. Sot dalin minimumi njëzet trajlerë në ditë. Është një kërkesë e hershme e bujqve, e grumbulluesve dhe e atyre që eksportojnë, për një degë doganore, e cila shpejton punën, rrit interesin dhe ul koston. Do t’ju flas shkurt, në mënyrë telegrafike. Për shëndetësinë, falënderoj ministren e Shëndetësisë dhe kabinetin qeveritar që është mundësuar një mamograf i ri në poliklinikën e Lushnjës. U bëj thirrje të gjitha grave e vajzave të Lushnjës që t’i drejtohen kësaj poliklinike, sepse jemi fiks në muajin e luftës kundër kancerit të gjirit. Dua të përshëndes Elena Kadarenë, e cila u bën thirrje të rinjve: lufta ndaj Covid-19 është luftë reale dhe të rinjtë kanë shumë të mira, por duhet të dëgjojnë edhe nga përvoja e hidhur që po ndodh, të vaksinohen jo si kërkesë e modës, por si domosdoshmëri. Dua të them dy fjalë për opozitën. Ka një shprehje të popujve të ndryshëm që thotë: “Palumturia në familje ose e një personi të saj, sjell palumturi kudo.” Unë e di që opozita është e palumtur. Ka një luftë të brendshme, është në hall të madh, por duhet të kujtoni një gjë: çdo luftë, çdo thënie në të bardhë e të zezë ju largon nga qytetari. Ju bëj një thirrje shumë qytetare, pa bindje politike, sepse të gjithë votuesit tuaj, edhe ata të djathtët, e duan Shqipërinë si gjithë Europa: ju lutem, kursejini fjalët duke e sharë në gjuhë të huaj Shqipërinë dhe ëndrrën tonë. Këtu, në këtë sallë, në shqip mund të thoni çfarë të doni, sepse, sa më shumë të flisni dhe të shani ato çfarë janë bërë, aq më të sigurt e keni humbjen e radhës. Kjo është e domosdoshme dhe besoj se edhe fëmijët tuaj nuk janë dakord me qëndrimin tuaj. Bota na sjell progres-raporte pozitive, ju i shani duke përmendur gjithçka në gjuhë të huaj. Këtë e kanë të qartë edhe në Komisionin e Integritetit ku jam unë, por edhe në komisione të tjera. Është mani të shash, të pështysh çdo punë të mirë. Faleminderit!

